

Siguri

Ekskluzive | Shkoi për të mbledhur kërpudha në Bjeshkët e Junikut, zbulon granata dore dhe mbi 120 fishekë



Sinjali.com

03 Korrik 2026 12:38



Një qytetar që kishte dalë për të mbledhur kërpudha në Bjeshkët e Junikut ka hasur në mjete të pashpërthyera dhe municion, duke alarmuar menjëherë Policinë e Kosovës, raporton Sinjali.

Burimet e Sinjalit bëjnë të ditur se rasti është raportuar nga F. K., 55-vjeçar, i cili kishte vërejtur objektet e dyshimta në vendin e njohur si "Zharre".

Pas njoftimit, njësitet policore kanë dalë në vendin e ngjarjes dhe kanë konstatuar se bëhej fjalë për dy granata dore të kategorisë A-1.

Më vonë në vendngjarje kanë intervenuar edhe njësia për Deminim e FSK-së dhe njësia amerikane e KFOR-it, të cilat kanë kryer shpërthimin e kontrolluar të mjeteve.

Gjatë operacionit janë gjetur dhe asgjësuar dy granata dore dhe 122 fishekë të kalibrit 7.62 mm.

Sipas burimeve, operacioni është zhvilluar pa asnjë incident dhe nuk ka pasur rrezik për qytetarët.

Sinjali – aty ku e vërteta flet para lajmit!

/GazetaSinjali/

Sinjali

Gazeta Sinjali mirëmbahet nga kompania "Sinjali" sh.p.k. Materialet dhe informacionet e Gazetës Sinjali nuk mund të kopjohen, të shtypen, ose të përdoren në çfarëdo forme tjetër, pa leje nga redaksia.



Lajme

Zgjedhjet 2026
Kosovë
Shqipëri
Rajon
Diasporë
Evropë
Botë

Aktualitet

Politikë
Drejtësi
Siguri
Shëndetësi
Arsim
Sociale

Hulumtime

Ekskluzive
Profile
Skandaloze

Ekonomi

Prodhime Vendore
Financa
Biznes

Sport

Botërori 2026
Futboll
Basketboll
Sporte Luftarake
Sporte të tjera

Showbiz

Bota e Yjeve
Modë & Stil
Bukuri dhe kujdes
Të tjera

OP-ED

Analizë
Kolumne
Intervistë

Jetë

Fitness
Ushqime
Travel
Këshilla
Receta
Dieta
Shëndeti

Kulturë

Film
Muzikë
TV & Radio
Libra
Art & Dizajn
Fotografi
Histori

Tech & Auto

Teknologji
Automjete
Telefona
Internet
Lojëra
Aplikacione

Fun

Qesharake
Kuriozitete
Kuize
Fakte
Të tjera